

## PROGRAMI I PËRBASHKËT I KOMBEVE TË BASHKUARA

# “Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Lokale të Mbrojtjes Sociale”

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planeve Lokale Sociale



## Tabela e Përmbajtjes

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planeve Lokale Sociale.....	1
Përmbledhje .....	3
Hyrje: Sistemi i Mbrojtjes dhe Kujdesit Social në Shqipëri .....	3
Monitorimi Indikatorëve të Mbrojtjes Sociale .....	4
Indikatorët dhe Rezultatet e synuara (target).....	7
<b>KONCEPTET BAZË TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT .....</b>	<b>12</b>
Çfarë është Monitorimi?.....	12
Principet bazë të Monitorimit Cilësor.....	15
Nivelet e monitorimit .....	15
Modele të monitorimit të Programeve/Projekteve.....	17
Shpeshësia e Procesit të Monitorimit .....	19
Organizimi procesit të Monitorimit.....	20
Çfarë është Vlerësimi?.....	21
Qëllimi i Vlerësimit .....	21
Klasifikimi i Vlerësimit .....	22
Llojet dhe pyetjet e Vlerësimit?.....	23
Diferenca midis Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V).....	24
Formatet e Raportimit të Monitorimit dhe Vlerësimit .....	25
Ankes A: Matrica e Monitorim&Vlerësimit dhe Formatit i Raportimit .....	33

## Përmbledhje

Tashmë, Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të zhvillimit dhe zgjerimit të paketës së shërbimeve dhe mbrojtjes sociale, duke ju dhënë më shumë fuqi dhe hapësira pushtetit vendor me qëllim që sistemi të bëhet funksional si dhe të ofroj një gamë të gjerë shërbimesh në nivel vendor. Një komponent i rëndësishëm në këtë drejtim është dhe hartimi i Planeve të Shërbimeve Sociale në nivel Bashkie. Plani i shërbimeve sociale është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Përmes hartimit, monitorimin dhe vlerësimit të impaktit të zbatimit të programeve të mbrojtjes sociale planifikuar në Planet Lokale të Shërbimeve Sociale, synohet që çdo qytetar shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, të gëzojë shërbime publike cilësore.

Programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara "Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Lokale të Mbrojtjes Sociale" po ju ofron asistencë teknike bashkive: Rrogozhinë, Devoll, Kamëz, Pukë, Skrapar, Polican dhe Fushë-Arrëz të hartojnë dhe administrojnë planet locale sociale. Ky program zbatohet nga Qeveria e Shqipërisë në partneritet me katër Agjenci të OKB, përfshirë UNDP, UNICEF, UN Women dhe OBSH dhe pjesëmarrjen e UNFPA dhe ILO, dhe financohet nga Fondi i Përbashkët i Objektive të Zhvillimit të Qendrueshëm (SDG Fund). Programi synon të mbështesi Qeverinë Shqiptare të përkthejë qëllimin e politikave në veprime të duhura lokale, në mënyrë që burrat, gratë, vajzat dhe djemtë që jetojnë në varfëri, ose situata në nevojë, të kenë akses në shërbime të integruara dhe cilësore të kujdesit shoqëror, si dhe mbështet vizionin e përgjithshëm të një Shqipërie gjithëpërfshirëse.

## Hyrje: Sistemi i Mbrojtjes dhe Kujdesit Social në Shqipëri

Me mbrojtje sociale kuptojmë grupin e strategjive dhe programeve në nivel kombëtar të cilat janë krijuar për të parandaluar dhe zbutur varfërinë dhe vulnerabilitetin e njerëzve në nevojë, përmes mbështetjes nga fondet e qeverisë apo donatorëve të huaj<sup>1</sup>. Objektivi kryesor i mbrojtjes sociale është të mbroj individët dhe grupet në nevojë nga varfëria dhe përjashtimi social.

Në vendin tonë, pas viteve 90-t sistemi i kujdesit dhe mbrojtjes sociale ka ardhur në përmirësim, zhvillim që reflektohet përmes përmirësimit dhe zgjerimit të kuadrit ligjor, reformës në pensione apo rritjen e buxhetit për shërbimet sociale dhe grupet në nevojë. Vlen të theksohet, mbështetja e pushtetit qendror dhe vendor në hartimin dhe zbatimin e dokumentave politik, të tillë si: Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2015-2020, riparë 2019-2022), Dokumenti Politik mbi Përfshirjen Sociale (2016 -2020), Ligji mbi shërbimet e kujdesit social (2016), ngritja e Fondit Social (2018), etj.

<sup>1</sup> <https://www.un.org/development/desa/dspd/ep-content/uploads/sites/22/2018/07/1-1.pdf>

Përmes hartimit të dokumentave të ndryshëm politik dhe zbatimit të programeve të mbrojtjes sociale, synohet që çdo qytetar shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore. **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale** përmes tre politikave<sup>2</sup> synon, të mundësoj mbrojtje, përfshirje dhe rinteprim social për personat dhe familjet e prekura nga varfëria, si dhe individë në situatë vulnerabiliteti, të shprehura në tre shtylla kryesore si më poshtë:

A. *Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë*, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shenjëstrimit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre.

B. *Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara*, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në *Cash* me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

C. *Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social*, bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri.

Në Shqipëri programet e mbrojtjes sociale, kryesisht mbështeten nga fondet e qeverisë dhe të bashkive. Programet më kryesore që zbatohen aktualisht janë:

- Ndihma Ekonomike (NE)
- Pa Aftësisë së Kufizuar (PAK)
- Skema e Pensioneve
- Kujdesi dhe Sigurimi shëndetësor
- Pagesa e barrëlindjes
- Pagesa për të porsalindurit (bonusi bebes)
- Pagesa papunësisë
- Shërbimet e kujdesit social (ditore dhe rezidenciale)

Në të njëjtën kohë, përmes organizatave të shoqërisë civile me mbështetjen e donatorëve të huaj, ofrohen shërbime të kufizuara të mbrojtjes sociale për grupet nevojë kryesisht përmes qendrave rezidenciale (ditore apo me fjetje) dhe programeve të tjera mbështetëse.

## Monitorimi Indikatorëve të Mbrojtjes Sociale

Në kornizën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals/SDG) mbrojtja sociale është pjesë e disa Objektivave (1, 3, 5 dhe 8) dhe target: 1.3; 3.8; 5.4 dhe 8.5

<sup>2</sup> *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015- 2020, fq.24, aksesuar në [https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Mbrojtjen\\_Sociale\\_2015-2020.pdf](https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf)*

Indikator më i rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes sociale është indikator 1.3 i lidhur direkt me sistemin e mbrojtjes sociale, uljen e varfërisë dhe matjen e shërbimeve të mbrojtjes sociale në nivel kombëtar për personat nga grupet në nevojë. Specifikisht ky indikator vlerëson përqindjen e popullatës të mbuluar nga skemat e mbrojtjes sociale, i ndarë sipas gjinisë dhe kategorive të mbrojtjes sociale, si p.sh.: numrit të fëmijëve përfitues, të papunëve, të moshuarëve, personave me aftësi të kufizuar, grave shtatzëna, të porsalindurit, viktimat nga aksidentet në punë, si dhe personat nga familjet e varfëra apo ato nga grupet vulnerable.

Ky indikator mat përqindjen e personave të mbuluar nga të paktën një prej skemave të kujdesit dhe mbrojtjes sociale. Pra, në thelb, ai fokusohet kryesisht në mbulesën e shërbimeve, dhe është indikator që mat efektin e ndërhyrjes, i disagreguar sipas përbërjes socio-ekonomike dhe demografike. Metodologjia bazë për matjen e këtij indikator është ajo e ILO (International Labor Organization) që në fakt është metodologjia bazë që përdoret për matjen e indikatorëve në nivel global dhe më pas botuar periodikisht në World Social Protection Report.

Në Shqipëri, janë disa përpjekje për të matur progresin dhe mbulesën e popullatës në nevojë me shërbimet sociale, por këto raporte kanë qenë më tepër pjesë e vlerësimit të arritjeve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), sesa të fokusuar direkt në matjen e indikatorëve të performancës së shërbimeve të kujdesit social.

Tashmë, Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të zhvillimit dhe zgjerimit të paketës së shërbimeve dhe mbrojtjes sociale, duke ju dhënë më shumë fuqi dhe hapësira pushtetit vendor me qëllim që sistemi të bëhet funksional si dhe të ofroj modelin e paketës standarte të shërbimeve në nivel vendor. Një komponent i rëndësishëm në këtë drejtim është dhe hartimi i Planeve të Shërbimeve Sociale në nivel Bashkie.

Plani i shërbimeve sociale është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Risi në këtë drejtim është fakti që Planet e Shërbimeve Sociale, krahas mbështetjes ligjore, janë të shoqëruara edhe me Planin e Veprimit (2017-2020 dhe 2020 - 2023) i cili është i ndarë në pesë fusha kryesore :

1. Strukturat dhe burimet njerzore;
2. Shërbimet sociale në Bashkinë;
3. Zbutja e varfërisë;
4. Programet parandaluese;
5. Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve dhe përcakton qëllimet dhe objektivat specifike, aktivitete e parashikuara në terma kohorë, përgjegjësitë institucionale dhe burimet për realizimin e tyre.

Në të njëjtën kohë, me ngritjen e Fondit Social, tashmë Bashkitë kanë të drejtë të aplikojnë për projekte si entitet më vete, gjë e cila do të rriste shanset për buxhetim më të madh të projekteve sociale por dhe zgjerimin e mbulesës së shërbimeve sociale për grupet në nevojë.

Së fundmi, UNDP ka mbështetur Bashkitë në hartimin e Planeve Lokale me qëllim adresimin më të mirë të nevojave për mbrojtje sociale të grupeve në nevojë. Në të njëjtën kohë, mbështetje është ofruar për punonjësit e bashkive dhe partnerëve për trajnimin dhe fuqizimin e tyre mbi procesin e planifikimit, buxhetimit dhe

monitorimit të shërbimeve sociale. Me qëllim krijimin e një dokumenti bazë dhe lehtësisht të përdorshëm nga të gjithë punonjësit që mbulojnë shërbimet sociale, UNDP mbështeti hartimin e metodologjisë së vlerësimit të Planeve të Shërbimit Social në Bashki.

Qëllimi i këtij dokumenti është hartimi i metodologjisë së vlerësimit mbi shkallën e vlerësimit të Planeve Lokale Sociale në nivel Bashkie, dhe të shërbejë si një mekanizëm për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin sistematik dhe rutinë të ecurisë së indikatorëve të planeve të shërbimit social.

Në mënyrë specifike, ky dokument do të ndihmojnë në:

- Ofrimin e fakteve bazë që do të lehtësojnë procesin e hartimit të politikave, vendim-marrjes, koordinimin dhe mirë-përdorimin e burimeve financiare;
- Sigurojë të dhëna të vlefshme mbi arritjen e objektivave dhe progresin e performancë së Planeve Sociale, dhe
- Hartimin e një kuadri llogjik për identifikimin, matjen dhe vlerësimin e indikatorëve gjatë procesit të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit.

## Indikatorët dhe Rezultatet e synuara (target)

Indikatorët dhe targetat janë elementikuç apo “shtylla kurrizore” e sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V). Ata janë pjesë e mbledhjes së informacionit për të matur ndryshimin dhe performancën e një projekti apo programi. Pra, indikatorët tregojnë nëse objektivi është arritur apo jo. Ndërsa objektivi, shërben për të treguar ndryshimet apo rezultatet e synuara që një program kërkon të arrijë.

### Çfarë janë Indikatorët?

Indikatorit është një variabël, njësi apo kriter që mat një aspekt të programit/projektit. Pra, në mënyrë të përmbledhur, një indikator verifikon nëse ka ndodhur ndryshimi i planifikuar apo jo.

Indikatorët janë pjesë e rëndësishme e çdo projekti, vecanërisht në procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Rëndësia e tyre varet nga fazat e zhvillimit dhe llojit të projektit, siç përshkruhet më poshtë:

1. Në fazën fillestare të projektit, indikatorët shërbejnë për të përcaktuar se si do të matet/vlerësohet ecuria e ndërhyrjes. Përmes tyre, drejtuesit e projektit janë në gjendje të paracaktojnë matjen e progresit të ndërhyrjes në mënyrën e duhur.
2. Gjatë fazës së zbatimit, indikatorët shërbejnë për të vlerësuar progresin aktual të ndërhyrjes dhe të rekomandojnë ndryshimet e mundshme në kornizën logjike të projektit.
3. Ndërsa në fazën e vlerësimit, indikatorët shërbejnë si bazë për të vlerësuar ndikimin apo impaktin e projektit.

Rekomandohet që çdo aktivitet të ketë të paktën një indikator. Ata mund të maten në forma të ndryshme, si psh: përmes “numrave”, përqindjes, proporcioneve apo indekseve (Tabela 1).

Table 1: Indikatorët dhe njësia matëse e tyre

INDIKATORI	NJËSIA MATËSE
Persona të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve sociale	<b>Numerike</b> ( <i>numri personave të trajnuar</i> )
Qendrat Shëndetësore (QSH) që përfitojnë nga investimet e programit të vaksinimit	<b>Përqindje</b> ( <i>përqindja e QSH që ofrojnë vakcina për fëmijë 0-18 vjeç</i> )
Vdekshmëria foshnjore	<b>Niveli</b> (rate) i vdekshmëris foshnjore në nivel vendi
Fertiliteti në nivel Qarku	<b>Norma</b> (ratio) e fertilitetit në nivel Qarku

Indikatorët që janë të shprehur në përqindje, përbëhen nga numëruesi dhe emëruesi. Është shumë e rëndësishme që në matjen e indikatorit, denominatori të jetë i përcaktuar qartë, pasi është një faktor i rëndësishëm në llogaritjen e rezultatit.

Shembull: % e QSH që ofrojnë programe vaksinimi = **Numëruesi:** Nr. QSH që ofrojnë programe vaksinimi / **Emëruesi:** numri total i QSH, shumëzuar me 100.

### Llojet e indikatorëve

Janë pesë (5) lloje të ndryshëm indikatorësh që përdoren në sistemin e Monitorim/Vlerësimit. Ato tregojnë apo shpjegojnë se Çfarëçfarë ka ndodhur apo po ndodh me projektin. Në Tabelën 2, paraqiten në mënyrë të përmbledhur indikatorët kryesor që përdoren në procesin e M&V.

Table 2: Llojet e indikatorëve

INDIKATORËT	ÇFARË MASIN?	KU PËRDOREN?
Burimet (input)	Kryesisht se Çfarë ka apo po ndodh në program. P.sh: numrin e materialeve trajnuese, antarët e stafit, infrastrukturën, etj.	Procesi Monitorimit
Aktivitete (process)	Numrin e aktiviteteve të kryera apo të realizuara, si: numrin e trajnimeve, numri vizitave në terren.	
Produkte (output)	Numrin e materialeve të prodhuara si rezultat i zbatimit të projektit. P.sh: numrin e stafit të trajnuar, numrin e fletëpalosjeve të shpërndara, numrin e qendrave sociale të ngritura, etj.	
Rezultate (outcome)	Matin ndryshimet në nivel sistemi apo ato sjellore, të ardhura si rezultat i projektit. P.sh: përqindja e të rinjve që ndjekin arsimin profesional, numri i Qendrave Sociale që aplikojnë standartet e cilësisë, etj.	Procesi Vlerësimit
Ndikimi (impact)	Matin ndryshimet madhore që kanë ardhur si rezultat i ndikimit të projektit. P.sh: përqindja e personave të moshës së tretë me sëmundje kronike apo përqindja e të rinjve të papunë që kanë ndjekur arsimin profesional dhe janë të suksesshëm në tregun e punës.	

Megjithatë, indikatorët më të përdorshëm janë atë që përdoren për vlerësimin e procesit, efekteve dhe ndikimit të aktiviteteve të projektit.



## Disa faktorë që ndikojnë në cilësinë apo besueshmërinë e indikatorëve

Për të qenë të besueshëm, të arritshëm dhe cilësorë, indikatorit duhet të jenë:

Efektiv	• të masin në mënyrën e duhur ndryshimet në sjellje, në praktikë apo objektivat e përcaktuar.
Matshëm	• të jetë lehtësisht i matshëm përmes metodave egzistuese të vlerësimit.
Besueshëm	• të prodhojë të njëjtat rezultate edhe kur matet apo vlerësohet me metoda të ndryshme vlerësimi.
Saktë	• të jetë i shprehur qartë si në aktivitete ashtu dhe në rezultate.
Në kohë	• të jetë i shprehur saktë në terma dhe afate kohore, si dhe i përshtatshëm në lidhje me objektivat dhe aktivitetet e programit.
Programatik	• i lidhur ngushtë me objektivat e projektit që ndikojnë drejt për drejt në arritjen e objektivave afat-gjatë apo ndryshimeve madhore.

## Shembuj të indikatorëve cilësor/besueshëm

**Efkti (Outcome):** Programet e Planifikimit Familjar synojnë të mënjanojnë shtatzënitë e padëshiruara dhe abortin e pasigurt.

**Indikator ideal:** Numri i fëmijve që një grua në moshë riprodhuese dëshiron të ketë.

**Ndikimi:** Programet e Planifikimit Familjar synojnë të ulin sëmundshmërinë amtare dhe foshnjore.

**Idikator ideal:** Niveli i vdekshmërisë së nënave (mëmësore)

Në tabelën 3, paraqiten në mënyrë të përmbledhur shembuj të indikatorëve cilësorë dhe mënyra e paraqitjes së tyre për të shmangur paqartësitë në formulimin e tyre.

Table 3: shembuj të indikatorëve cilësorë

Indikatorë komplikuar	<i>Problematika e indikatorit</i>	Indikatorë cilësor
Rritja e numrit të të rinjve të rregjistruar në programet e punësimit	Në këtë rast, fjala “ritje” nënkupton target dhe duhet të shmanget.	Përqindja apo numri i të rinjve të rregjistruar në programet e punësimit.
Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të programeve të mbrojtjes sociale	Është tepër e vështirë se si do të matet përmirësimi cilësisë së shërbimit. Pra fjala “përmirësim” duhet hequr.	Përqindja e klientëve të kënaqur me cilësinë e shërbimit të programeve të mbrojtjes sociale.
Në fund të 2022, rreth 10.000 fëmijë nga komunitet vulnerable do të kenë përfituar nga programi i NE	Afati dhe numri fëmijëve që do të arrihen, shprehin target dhe mbivendosen me indikatorin.	Numri i fëmijëve 0-18 vjec që përfitojnë nga program i NE.
Qasja ndaj shërbimeve miqësore për të rinjtë do të rritet me 50% në fund të vitit 2022.	Indikatorin nuk duhet të konfuzohet me target (përqindja dhe afati kohor).	Përqindja e popullatës që marrin shërbime miqësore për të rinjtë.

## Indikatorët dhe Rezultatet e synuara (target)

Shpesh indikatorët ngatërrohen me targetat. Për të shmangur konfuzitetin në lidhje me indikatorët dhe targetin është e rëndësishme që indikatorët dhe target të prezantohen të ndara<sup>3</sup> (Tabela 4 dhe 5).

Table 4: Shembull ilustrativ i prezantimit të indikatorëve dhe target

Indikatorët dhe target të shprehura së bashku	Indikatorët dhe Targeti të shprehura si linjë më vete
<b>Indikator:</b> 15.000 persona do të përfitojnë NE deri në vitin 2022.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Indikator:</b> Numri personave që do të përfitojnë nga programi NE.</li> <li>• <b>Treguesi bazë:</b> 10.000 persona në vitin 2021.</li> <li>• <b>Synimi:</b> 15.000 persona në fund të vitit 2022.</li> </ul>

<sup>3</sup>[https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/253889/using-revised-logical-frame-ork-external.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/253889/using-revised-logical-frame-ork-external.pdf)

## Vlerësimi i Performancës

Për të vlerësuar performancën e një projekti, nuk nevojitet vetëm të mbledhësh informacion mbi arritjet apo aktivitetet e kryera. Mbi të gjitha është të analizosh dhe të vlerësosh se si janë arritur objektivat, cilët janë Çfarëfaktorët që kanë ndikuar pozitivisht apo negativisht në ecurinë e projektit, pengesat me të cilat u përball zbatimi I projektit/programitÇfarë, personat përgjegjës për zbatimin e aktivitetëve, partnerët, etj.

Indikatorët e performancës përfaqësojnë planin për arritjen në kohë dhe cilësi të rezultateve të projektit. Synimet në vetvete janë vlerat e planifikuara për secilin indikator. Në varësi të indikatorit, ato mund të jenë cilësore dhe sasiore. Për shembull, nëse vlera e matjes së indikatorit është sasiore (numri trajnimeve për punonjësit social në bashki) atëherë rezultati synuar është 1 trajnim/muaj apo 20 punonjës të trajnuar. Megjithatë, për nevoja të ndryshme, indikatorët sasiore mund të interpretohen dhe në mënyrë cilësore.



## Pyetjet që ju përgjigjet Monitorimi

A janë hyrjet (input) të arritshme, përshtatshme dhe kost-efektive ?
A po kryhen aktivitetet në mënyrën e duhur? Nëse JO, pse?
A po arrihen rezultatet e pritshme?
A po ndikojnë rezultatet në arritjen qëllimit të ndërhyrjes?
A është arritur plotësisht popullata e fokusuar?
A po merr përfitimet duhura popullata e fokusuar?
A është e nevojshme të përshtatet/ndryshoj ndërhyrja?
A ka diferenca/problematika në zona të ndryshme ku zbatohet ndërhyrja?

## Llojet e Monitorimit

Në praktikë egzistojnë modele të ndryshme të procesit të monitorimit, të cilat aplikohen veçmas apo të integruara, kjo në varësi të llojit të programit, aktiviteteteve apo rezultateve të dëshiruara.

**Tabela 5: Modelet e monitorimit**

Modele Monitorimi	Çfarë dhe Si?
<b>Monitorimi performancës</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitoron përdorimin e burimeve, progresin e aktiviteteteve dhe shpërndarjen e rezultateve.</li> <li>- Vlerëson nëse aktivitetet janë kryer në kohë dhe burimet e përdorura janë përdorur në mënyrën e duhur.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes supervizimit periodik, vlerësimit të raporteve, të dhënave administrative apo gjetjeve nga raportet e auditit.</li> </ul>
<b>Monitorimi Financiar</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitoron shpenzimet financiare, rimbursimet, shpenzimet me para në dorë (cash), për të vlerësuar kost-efektivitetin e ndërhyrjes dhe përdorimin korrekt të fondeve.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes supervizimit periodik, raporteve financiare, të dhënave administrative apo gjetjeve nga raportet e auditit.</li> </ul>
<b>Monitorimi Analitik</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizon metodat e përdorura në zbatimin e ndërhyrjes.</li> <li>- Identifikon problemet që mund të kenë shkaktuar vonesa/pengesa apo kanë ndikuar në arritjen e objektivave.</li> <li>- Ofron zgjidhje për kapërcimin e problematikave.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes supervizimit periodik, vlerësimit të raporteve, diskutimeve me zbatuesit, partnerët dhe përfituesit e ndërhyrjes.</li> </ul>
<b>Monitorimi Operativ</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson kapacitetin e projektit/programit për vazhdimësinë dhe përfitimet e ndërhyrjes.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes supervizimit periodik, vlerësimit të raporteve, diskutimeve me zbatuesit, partnerët dhe përfituesit e ndërhyrjes.</li> </ul>
<b>Monitorimi Përshtatshmërisë</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson përshtatshmërinë e ndërhyrjes në lidhje me rregullat e donatorit/institucionit/qeveris, rezultatet e pritshme, çështjet etike, etj.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshtatshmëri me standartet kombëtare dhe ndërkohmbëtare dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.</li> </ul>
<b>Monitorimi Situatës</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitoron mjedisin në të cilin projekti/programi operon, duke vlerësuar rreziqet, sugjerimet dhe problematikave të mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të projektit.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes vlerësimit të situatë politike në vend/rajon, reformave institucionale, financiare apo ndryshimit të politikave që prekin direkt performancën e ndërhyrjes.</li> </ul>
<b>Monitorimi Opinioneve/ Përshtypjeve</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitoron shkallën e vlerësimit/perceptimit apo ankesave, nivelin e pjesëmarrjes, adresimin e problematikave dhe eksperiencës së fituar.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimit të mekanizmit të vlerësimit të përshtypjeve, sugjerimeve, ankesat nga partnerët apo përfituesit e ndërhyrjes.</li> </ul>

<b>Monitorimi Organizativ</b>	<p><b>Çfarë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitoron qëndrueshmërinë, zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteve të stafit të projektit/programit apo partnerëve.</li> </ul> <p><b>Si?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Takime apo trajnime periodike, si dhe adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të ndërhyrjes.</li> </ul>
-------------------------------	--

### Principet bazë të Monitorimit Cilësor

Për një Monitorim cilësor, është e rëndësishme që procesi të jetë i bazuar në:

- **Rezultate:** është e rëndësishme që të analizohet dhe vlerësohet se çfarë ka shkuar mirë dhe ëfarë pengesash apo vështirësi janë hasur. Gjetjet nga procesi monitorimit duhet të shoqërohen me rekomandimet dhe veprimet përkatëse që do të ndihmojnë në arritjen e objektivave të planifikuara.
- **Verifikim dhe Përshtatje:** monitorimi është një proces në vazhdimësi dhe jo thjesht observim në fund të ndërhyrjes. Gjetjet nga vizitat monitoruese duhet të jenë të verifikueshme dhe rekomandimet të përshtaten sipas kushteve dhe nevojave aktuale.
- **Pjesëmarrje aktive:** monitorimi nuk është një proces që kryhet vetëm nga një person, por përkundrazi kërkon përfshirjen, angazhimin dhe kontributin e shumë aktorëve.
- **Indikatorë:** një indikator i mirë bazohet në të dhënat fillestare dhe synime realiste.
- **Program të mirë dizenuar dhe ideuar:** i cili ka një plan të qartë pune, bazuar në aktivitete dhe rezultate realiste dhe të arritshme.
- **Monitorim sensitiv:** i cili merr në konsideratë faktorë të ndryshëm, të tillë si: social, ekonomik, politik, fetar, mjedisor, gjinor dhe kulturor.

### Nivelet e monitorimit

Më i zakonshëm është monitorimi i zbatimit të programeve apo projekteve. Fokusi kryesor është në monitorimin e objektivave madhor dhe arritjen e indikatorëve të planifikuar. Zakonisht vlerëson cilësinë e aktiviteteve dhe kohështirjen e tyre, si dhe identifikon problematikën e hasur dhe sugjeron rekomandimet përkatëse për përmirësimin e punës së programit.

Përfitimet nga ky lloj monitorimi, janë si më poshtë:

- Siguron cilësinë e zbatimit të planit të aktiviteteve dhe arritjen e objektivave/indikatorëve.

- Forcon kapacitetet teknike të stafit të projekteve dhe lehtëson procesin e zbatimit të programit.
- Mësimet e nxjerra nga procesi monitorimit kthehen në praktika të mira pune.
- Rritjen e procesit të transparencës dhe besueshmërisë.
- Forcimin e partneritetit me partnerët e projektit.
- Shërbime më cilësore për popullatën e fokusuar apo përfituesit e programit.

Në tabelën 6, 7 dhe 8 jepen në mënyrë të detajuar nivelet e monitorimit, përshkrimi aktiviteteve dhe shembuj ilustrues.

Tabela 6: Nivelet e monitorimit dhe përshkrimi aktiviteteve

Nivelet e Monitorimit	Përshkrimi aktiviteteve
<b>Kombëtar</b>	Kryhet nga institucione/agjensi të specializuara në nivel kombatar. <b>Shembull:</b> Monitorimi i Planeve Lokale Sociale mund të kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror apo agjensi/institucione të specializuara të nënkontraktuara.
<b>Sektorial</b>	Kryhet nga vetë institucioni dhe monitoron zbatimin e projekteve/aktiviteteve në nivel sektorial. Formatet dhe matricat e monitorimit janë të dizenuara nga institucioni. <b>Shembull:</b> Sektori Mbrojtjes Sociale në MSHMS, monitoron ecurinë e zbatimit në praktikë të Planeve Lokale Sociale.
<b>Rajonal</b>	Kryhet nga institucione/agjensi të specializuara në nivel kombëtarë. <b>Shembull:</b> Monitorimi i Planeve Lokale Sociale mund të kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo agjensi/institucione të specializuara të nënkontraktuara.
<b>Bashkie</b>	Kryhet nga vetë institucioni dhe monitoron zbatimin e projekteve/aktiviteteve në nivel sektorial. Formatet dhe matricat e monitorimit janë të dizenuara nga institucioni. <b>Shembull:</b> Sektori Shërbimit Social në Bashki, monitoron ecurinë e zbatimit në praktikë të Planeve Lokale Sociale.



## Modele të monitorimit të Programeve/Projekteve

Table 7: Monitorimi Administrativ dhe Financiar

Monitorimi	Informacioni mbledhur	Burimi Informacionit	Përdorimi Informacionit të mbledhur
Personeli	<p>Performanca</p> <p>Arritjet</p> <p>Problematika</p> <p>Puna në grup</p>	<p>Takime pune</p> <p>Raportime nga drejtuesi/supervizori</p> <p>Vlerësimi performance</p> <p>Observime</p>	<p>Trajnime personeli</p> <p>Rishikimi kushteve të punës</p> <p>Rishikimi i termave kontraktual/kalimi në pozicion më të përshtatshëm</p> <p>Nxitje dhe motivim personeli</p>
Pajisjet	<p>Kur dhe Çfarë pajisjesh duhen blerë</p> <p>Listë çmimesh nga ofertues të ndryshëm</p> <p>Gjendja aktuale e stokut dhe përditësim i cilësisë së pajisjeve aktuale</p> <p>Sasia e duhur dhe koha e nevojshme për sigurimin e pajisjeve që do të porositen</p>	<p>Katalog pajisjesh nga ofertuesi</p> <p>Gjendja e inventarit</p> <p>Sistemi i hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave të inventarit</p>	<p>Sigurimi pajisjeve sipas cilësisë dhe cmimit</p> <p>Sigurimi pajisjeve të porositura në kohën e duhur</p>
Buxheti dhe shpenzimet	<p>Shpenzimet e kryera nga programi sipas linjave të buxhetit</p> <p>Balanca e buxhetit në fund të raportimit financiar</p> <p>Tejkalim apo mbetje të shpenzimeve</p> <p>Shpenzime shtesë për shkak të inflacionit apo kursit të shkëmbimit.</p>	<p>Faturat e shpenzime</p> <p>Ndarja e buxhetit sipas linjave</p> <p>Analizim i zërave dhe shpenzimeve të buxhetit duke përdorur programe të certifikuara financiare</p> <p>Balanca në llogarinë bankare</p>	<p>Parashikimi të shpenzimeve të buxhetit</p> <p>Krahasimi kostove/shpenzimeve me projekte të njëjta</p> <p>Identifikimi problematikave financiare (tejkalimi apo mos realizime)</p>

			Analizë e kost-efektshëmrisë së projektit.
<b>Pagesat e stafit</b>	<p>Pagat e stafit</p> <p>Pagesa e sigurimeve shoqërore/shëndetësore dhe tatimi në burim</p> <p>Pagesa të tjera (dieta, udhëtime, akomodim, etj)</p>	<p>List presenca</p> <p>Mandat pagese</p> <p>Urdhër xhirimi</p>	<p>Siguron që personeli është paguar në kohën e duhur dhe sipas kontributit të dhënë</p> <p>Pagesat janë kryer në përputhje me ligjet financiare në fuqi</p> <p>Personeli pajiset me mandate pagese/urdhër xhirimi</p>

**Table 8: Monitorimi Produktivitetit**

Monitorimi Programit	Informacioni mbledhur	Burimi Informacionit	Përdorimi Informacionit të mbledhur
<b>Informacion mbi popullatën e fokusuar</b>	Kushtet socio-ekonomike, shëndetësore, politike dhe mjedisin në të cilin jeton grup-popullata e fokusuar	<p>Studime/botime referuese (baseline) nga burime të ndryshme</p> <p>Takim me partnerët dhe aktorët kryesor të programit</p> <p>Vëzhgime në terren</p>	<p>Përdorimi të dhënave fillestare (baseline) si bazë për matjen e progresit apo arritjeve të programit</p> <p>Reagim të shpejtë dhe efekti për ndryshimin e situatës</p> <p>Forcimi partneritetit me institucionet e linjës dhe organizatat partnere.</p>
<b>Kontributi (Input)</b>	<p>Çfarë nevojitet, si mund të gjenden dhe kur mund të sigurohen</p> <p>Kosto e kontributit apo materialeve</p>	<p>Ofertuesit</p> <p>Partnerët e projektit</p>	<p>Hartimi planit të punës dhe grafiku aktiviteve</p> <p>Monitorimi i kostove dhe shpenzimeve buxhetore</p>
<b>Aktivitetet</b>	<p>Çfarë është arritur dhe Çfarë jo</p> <p>Aktivitete të kryera jashtë planit të miratuar</p>	<p>Raportimet periodike dhe të dhënat e mbledhura nga aktiviteti programit</p> <p>Gjetjet apo sugjerimet e mbledhura nga takime me</p>	<p>Planifikim më i mirë i aktiviteve në të ardhmen</p> <p>Identifikon praktikat e mira, pikat e dobëta dhe nxjerr</p>

	<p>Problematikat e hasura dhe si janë adresuar</p> <p>Faktorë të jashtëm që mund të kenë ndikuar në aktivitetet e programit</p> <p>Informacion tjetër me vlerë që nevojitet</p>	<p>partnerët/përfituesit e programit, takime pune, ëorkshop, etj</p> <p>Raportime nga burime të tjera (media, partnerët)</p> <p>Observime në terren</p> <p>Studime të ndryshme</p>	<p>“mësime” nga problematikat e hasura</p> <p>Përshtat aktivitetet apo prioritetet sipas mësimeve të nxjerra</p> <p>Identifikon nevojat (trajnime, staf, informacion, studime)</p>
<b>Menaxhimi</b>	<p>Si realizohet vendim-marrja</p> <p>Motivimi stafit</p> <p>Përfshirja e partnerëve dhe përfituesve në të gjithë fazat e zbatimit të programit</p>	<p>Rishikim i gjetjeve nga takimet e mëparshme</p> <p>Numri takimeve dhe larmishmëria e pjesëmarrësve</p> <p>Observime në terren</p> <p>Studime të ndryshme</p>	<p>Identifikimi nevojave për përfshirjen e aktorëve dhe partnerëve të ndryshëm</p> <p>Rishikimi mundësisë së ndryshimit të politikave të programit</p> <p>Identifikimi problematikave dhe adresimi i tyre</p>
<b>Arritjet</b>	<p>Rezultatet e arritura sipas planit fillestar</p> <p>A janë objektivat realist dhe të arritshëm</p>	<p>Informacion mbi indikatorët kyc</p> <p>Vëzhgime dhe supervizime</p> <p>Progres Raporte periodike</p>	<p>Rishikim i strategjive apo objektivave te projektit</p> <p>Opinione dhe rekomandime nga partnerët dhe përfituesit</p> <p>Vlerësimi nevojave per studime, monitorim/vlerësim</p> <p>Identifikimi nevojave për përmirësimin e sistemit të monitorimit</p>

## Shpeshtësia e Procesit të Monitorimit

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm që fillon që në fazat e para të hartimit të programit dhe mbaron me përfundimin e tij. Shpeshtësia e Monitorimit varet shumë nga natyra e indikatorit, lloji informacionit që do të mblidhet dhe mënyra e komunikimit për mbledhjen e informacionit. Disa ndërhyrje mund të kërkojnë që informacioni të mblidhet dhe raportohet në mënyrë ditore apo javore. Ndërsa të dhëna të tjerat mund të mblidhen apo raportohen në interval më të gjatë kohe (muajore, 3-mujore, 6-mujore, vjetore, etj.).

Në përgjithësi, shpeshësia e Monitorimit, varet nga faktorët e mëposhtëm:

- Lloji dhe qëllimi i ndërhyrjes
- Burimet (njerëzore, financiare, pajisjet)
- Nevoja për informacion/komunikim
- Niveli problematikave
- Kohëzgjatja dhe shtrirja gjeografike

Faktorë të tjerë të rëndësishëm që ndikojnë në shpeshësinë e monitorimit janë të lidhur me lehtësin apo vështirësit mbi mbledhjen e të dhënave dhe kostot përkatëse. Për shembull, të dhënat për indikatorët e shpenzimeve (input) mund të mbledhen në mënyrë më të shpeshtë (ditore/javore) dhe mund të raportohen në fund të çdo muaji apo 3-mujori. Ndërsa të dhënat për indikatorin e produktivitetit (output) mund të raportohen për një periudhë më të gjatë kohe (6-mujore apo vjetore).

Ndërsa të dhënat për efektin (impact) e ndërhyrjes mbledhen për një periudhë më të gjatë kohe, e cila varion nga 1 vit e më shumë.

## Organizimi procesit të Monitorimit

Ashtu sic përmendet më sipër, Monitorimi është një proces i vazhdueshëm, që përkon me ciklin e programit. Shpeshësia e monitorimit varet nga shumë faktorë, por për të siguruar një proces cilësor monitorimi, është e rekomandueshme të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Përgatitja në kohë për monitorim
- Hartimi dhe prioritizimi indikatorëve/aktivitetet që do të monitorohen
- Përcaktimi të dhënave fillestare (baseline) dhe ato që do të arrihen (target) për çdo indikator
- Përcaktimi personave përgjegjës për mbledhjen e të dhënave
- Ngritja e sistemit të Monitorimit&Vlerësimit për mbledhjen, ruajtjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave
- Përgatitja e instrumentave të monitorimit (pyetësorë, database, intervista, etj)
- Hartimi planit të punës dhe afatet kohore të monitorimit
- Analizimi dhe raportimi në kohë i gjetjeve nga monitorimi dhe zbatimi i tyre në praktik
- Rishikimi i indikatorëve, planit të aktiviteteve dhe sistemit të monitorimit (në rast nevojë)

## Përgatitja e materialeve për Monitorim

Monitorimi nuk është një proces i thjeshtë, që konsiston vetëm me vizita monitoruese apo mbledhje të dhënash mbi programin që po zbatohet. Është një proces kompleks dhe kërkon aftësi dhe mjete të caktuara, të cilat duhet të sigurohen që në fazat e hershme të hartimit të planit të procesit të monitorimit. Më poshtë, në mënyrë të pëmbledhur janë listuar disa hapa që duhet të ndiqen për të patur një proces cilësor monitorimi.

- Rishikim i informacioneve apo materialeve egzistuese mbi zbatimin e programit;
- Plan i qartë mbi qëllimin dhe mënyrën e organizimit të monitorimit;
- Përcaktimi i personave që do të kryejnë monitorimin dhe përcaktimi roleve/përgjegjësi;
- Organizimi i takimeve orientuese përpara çdo vizite monitorimit, me stafin që përgjegjës për monitorimin;
- Sigurimi të gjitha mjeteve/materialeve të nevojshme për monitorim (printimi materialeve, aparat fotografik, regjistruer, flepchart, lapsa, stilolapsa, mjet transporti dhe komunikimi, etj);
- Përgatitja e formateve të mbledhjes së të dhënave dhe mekanizmat e raportimit.

## Çfarë është Vlerësimi?

Në mënyrë të përmbledhur, Vlerësimi është procesi i të gjykuarit të një politike, programi apo projekti përpara, gjatë apo pas përfundimit të tij. Ai bazohet në mbledhjen sistematike dhe objektive të informacionit, si dhe analizimin e të dhënave mbi çështje të tilla si: relevancën, efektivitetin, eficientë, qëndrueshmërinë dhe ndikimin e ndërhyrjes. Vlerësimi mund të përfshijë pjesën e hartimit, zbatimit apo rezultateve të ndërhyrjes.

OECD/DAC<sup>5</sup> përcakton procesin e vlerësimit si: **Vlerësimi sistematik dhe objektiv i një projekti, programi apo politike, që mund të jetë në vazhdim apo në përfundim të ciklit të tij, fokusuar në strukturën, zbatimin dhe rezultatet e ndërhyrjes, duke përdorur kritere specifike vlerësimi.**

Rezultatet e vlerësimit përfshijnë një seri rekomandimesh që kanë për qëllim të adresojnë çështje të lidhura me dizënjimin apo planifikimin (objektivat), zbatimin (sigurimin e burimeve njerëzore dhe financiare) and mësimet e nxjerra, të cilat shërbejnë për përmirësimin e mëtejshëm të politikave, planifikimit apo buxhetimit të projektit.

## Qëllimi i Vlerësimit

Qëllimi strategjik i procesit të vlerësimit është të përmirësoj vendim-marrjen, mirë-përdorimin e burimeve njerëzore/financiare dhe të rrit besueshmërinë e ndërhyrjes. Megjithatë, vlerësimi i një ndërhyrjeje mund të bëhet për shumë arsye, të cilat janë përmbledhur si më poshtë:

- Përmirëson menaxhimin e projektit përmes sigurimit të informacionit në lidhje me politikën, zbatimin e aktiviteteve dhe performancën e projektit;
- Ofron informacion në lidhje me pikat e dobta dhe të forta, dhe ndihmon drejtuesit e projektit për një planifikim më të mirë të ndërhyrjes, shpërndarjen e shërbimeve dhe vendim-marrjen;

<sup>5</sup> Ibid: The Development Assistance Committee (DAC) of the Organization for Economic Cooperation and Development (OECD). Available at: [https://ëëë.oecd.org/dac/conflict-fragility-resilience/publications/ssr\\_section%2010.pdf](https://ëëë.oecd.org/dac/conflict-fragility-resilience/publications/ssr_section%2010.pdf)

- Ndhmon stafin dhe partnerët e projektit të përcaktojnë në mënyrë sistematike dhe objektive, përshtatshëm, efektivitetin dhe efencën e aktiviteteve, sipas objektivave specifike;
- Vlerëson suksesin e ndërhyrjes bazuar në ndikimin dhe qëndrueshmërin e rezultateve.

### Pyetjet që ju përgjigjet Vlerësimi

Cilat janë rezultatet e ndërhyrjes?
Çfarë ndryshimesh kanë ardhur si rezultat i zbatimit të ndërhyrjes?
A ka patur pengesa në realizimin e ndërhyrjes?
A ka patur ndikimi pozitiv/negativ zbatimi ndërhyrjes?
A është ndërhyrja e përshtatshme dhe e zbatueshme?
A janë të besueshme rezultatet?
A është kost-efektive ndërhyrja?
A ka nevojë për ndërhyrje/përmirësime të mëtejshme?
A mund të zgjerohet ndërhyrja, me qëllim rritjen e përfituesve?
Nëse PO, cilat janë rrugët dhe mundësitë?

### Klasifikimi i Vlerësimit

Procesi vlerësimit grupohet në varësi të objektivave të tij.

**Vlerësimi Formativ:** kryhet gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe shërben për të korigjuar apo përmirësuar formatimin e projektit.

**Vlerësimi Përmbledhës:** kryhet në fund të ndërhyrjes dhe shërben për të hedhur dritë mbi efektivitetin e ndërhyrjes, si dhe ofron mundësi për konsolidimin e praktikave të mira, të cilat mund të përdoren në ndërhyrjet pas ardhëse.

### Kur mund të kryhet Vlerësimi i një projekti?

Zakonisht, vlerësimi i një projekti kryhet gjatë gjithë ciklit të tij, pra që përpara fillimit të ndërhyrjes e deri në momentin që projekti ka mbaruar.

**Vlerësimi Fillestar (Ex- Ante):** kryhet në momentin para fillimit të ndërhyrjes me qëllim për të përcaktuar përshtatshmërinë apo mundësinë e zbatimit të projektit. Disa nga vlerësimet kryesore që analizohen në këtë fazë janë: kost-efektiviteti, kapaciteti teknik, politikat dhe mjedisi në të cilin do të zbatohet projekti, vlerësim nevojave, etj.

**Vlerësimi Gjysmë-jetës (mid-term):** kryhet në mes të ndërhyrjes apo në gjysmë-jetën e ciklit të projektit. Ka për qëllim të vlerësoj performancën dhe rezultatet e fazës së parë dhe propozoj ndryshime apo rekomandime, nëse është e nevojshme.

**Vlerësimi Përfundimtar (Final):** kryhet për të vlerësuar arritjet dhe sfidat gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit. Rezultatet nga ky vlerësim janë të një rëndësie të vecantë pasi ndihmojnë në hartimin e politikave apo strategjive për popullatat e synuara, të cilat kanë qenë përfituese të projektit që po vlerësohet.

**Vlerësimi Pas Ndërhyrjes (ex-post):** ky lloj vlerësimi kryhet pasi ka kaluar kohë nga përfundimi i projektit (zakonisht 1 vit apo më shumë) për të vlerësuar ndikimin (impact) e ndërhyrjes. Zakonisht, ndikimi vlerësohet me studime apo vlerësim të përfitimeve të ardhura si rezultat i zbatimit të projektit.

## Llojet dhe pyetjet e Vlerësimit?

**Vlerësimi i brendshëm,** kryhet nga vet agjensia zbatuese përmes ekspertëve apo specialistëve të saj.

Ndërsa, **vlerësimi i jashtëm** kryhet nga agjensi të specializuara të cilat nuk kanë konflikt interesi me agjensinë zbatuese.

## Pyetjet Vlerësuese

Nuk ka ndonjë formulë magjike në hartimin apo renditjen e pyetjeve që do të përdoren në një proces vlerësimi. Ato varen kryesisht nga lloji i projektit që po zbatohet, fusha, objektivat dhe popullata e synuar. Pyetjet kanë si qëllim për të kuptuar se Çfarë informacioni kërkon vlerësuesi të zbuloj gjatë procesit të vlerësimit.

Nëse pyesim, “*a ka qenë ndërhyrja e vlefshme*”, kjo është një ndër pyetjet më të zakonshme që përdorin vlerësuesit në fazat e para. Zakonisht, kjo hyn në grupin e pyetjeve “që thyejnë akullin” midis vlerësuesit dhe të intervistuarit. Më pas vijnë pyetjet më të detajuara apo të orientuara, të cilat kanë për qëllim të masim rëndësinë apo ndikimin e ndërhyrjes. Pyetje të tilla: “*cilat ishin disa nga efektet që rezultuan nga zbatimi i ndërhyrjes*” apo “*a u përdorën në mënyrë efikente fonde apo burimet njerëzore të projektit*”, janë pyetje të lidhura direkt me efektshëmërinë apo ndikimin e projektit.

Pyetjet që përdoren në një proces vlerësimi ndahen në tre (3) grupe: përshkruese (descriptive), normative dhe ndikuese (shkak-efekt).

**Pyetjet përshkruese:** kryesisht kanë për qëllim të vlerësojnë situatën aktuale të zbatimit të projektit dhe janë pyetje bazë për të patur një panoramë të shpejtë se Çfarë po ndodh aktualisht.

*Shembull:*

- Cili është qëllimi dhe objektivat e programit dhe sa mbulojnë ato nevojat e grupeve në nevojë?
- Mund të listoni disa nga aktivitetet kryesore që janë të lidhura me mbrojtjen sociale?
- Në Çfarë mase programi ka reflektuar zbatimin e mësimëve të nxjerra nga vlerësimet e mëparshme?

**Pyetje normative:** këto pyetje kanë për qëllim të krahasojnë situatën aktuale me atë që duhej të ishte sipas planifikimit fillestar të ndërhyrjes. Për shembull, pyetja “*a i ka arritur programi objektivat kryesor*” është pyetje që ka për qëllim të vlerësojë performancën e projektit në kuptimin normative.

*Shembull:*

- A janë arritur objektivat e projektit sipas planifikimit fillestar?
- A janë arritur indikatorët dhe target kryesor?
- A ka patur efekt ndërhyrja tek përfituesit?

**Pyetje ndikuese (shkak-efekt):** kanë për qëllim të vlerësojnë diferencën apo ndikimin që ka ardhur si rezultat i zbatimit të ndërhyrjes. Pyetjet vlerësojnë se Çfarë ka ndryshur në komunitet apo shoqëri, si rezultat i projektit.

*Shembull:*

- A ka ndikuar programi i Ndihmës Ekonomike në zbutjen e varfërisë?
- A ka ndikuar përmirësimi infrastrukturës së shkollave në uljen e numrit të nxënësve për klasë?
- A ka ndikuar përmirësimi i cilësisë së rrugëve në uljen e numrit të aksidenteve?

## Diferenca midis Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V)

Nëse procesi M&V ndërtohet në mënyrën e duhur që në fazat e hershme të ndërhyrjes, është një mjet i fuqishëm që ndihmon që projekti/program të eci në drejtimin e duhur.

M&E ndihmon në përmirësimin e procesit të performancës të projektit, siguron besueshmërin dhe qëndrueshmërin e tij, si dhe kontribuon në maksimizimin e rezultateve dhe ndikimit të ndërhyrjes.

M&V, edhe pse mund të mendohet si të ndara nga njëri-tjetri, janë dy koncepte të ndërvarura dhe shpesh kanë mbivendosje. Monitorimi i përgjigjet pyetjes se “*çfarë është zbatuar ose çfarë ka ndodhur*”, ndërsa vlerësimi i jep përgjigje pyetjes se “*çfarë ka ndryshuar si rezultat i ndërhyrjes*”. Përmes mbledhjes rutinë të të dhënave, montiromi ofron të dhëna cilësore dhe sasiore që janë të domosdoshme për procesin e vlerësimit. Pra, një proces i mirë



monitorimi, siguron kushtet për një proces esencial të vlerësimit që vlerëzon rezultatin dhe ndikimin që ka patur ndërhyrja.

M&V është proces që ndodh gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit, të ndërvarur me njëri-tjetrin, por me vecori specifike, të cilat varen gjerësisht nga lloji i ndërhyrjes dhe kushtet e zbatimit të saj.

Në tabelën e mëposhtme (Tabela 8), paraqiten në mënyrë të përmbledhur diferenca midis procesit të Monitorimit dhe Vlerësimit.

**Table 9: Diferenca midis Monitorimit dhe Vlerësimit**

Kriteret	Monitorimi	Vlerësimi
Justifikimi/Arsyeja	Ofron bazën për korrigjimin e ndërhyrjes	Vlerëson nëse ndërhyrja duhet vazhduar, përshtatur apo ndërprerë.
Fokusi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- A janë realizuar ndërhyrjet sipas planit?</li> <li>- A ka patur ndryshime të ndërhyrjes?</li> <li>- Nëse PO, kanë qenë të justifikueshme?</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Relevanca</li> <li>- Eficenca</li> <li>- Efektiviteti</li> <li>- Ndikimi</li> <li>- Qëndrueshmëria</li> </ul>
Koha	Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të ndërhyrjes.	<p>Përpara, mes dhe në fund të ndërhyrjes.</p> <p>Disa vite më pas për vlerësimin e ndërhyrjes.</p>
Indikatorët	Përkrahja rezultateve të pritshme për një aktivitet.	Analizon të dhënat e shumë aktiviteteve.
Personat e përfshirë	Përfshihen shumë persona	Sasi e limituar e grupit të ekspertëve.
Burimi Informacionit	Mbledhje rutinë e informacionit, vëzhgime në terren, raporte periodike dhe vlerësime të shpejta.	Studime dhe Vlerësime
Kush e kryen	Punonjës të projektit	Kryesisht nga vlerësues të jashtëm.

## Formatet e Raportimit të Monitorimit dhe Vlerësimit

Çdo dokument (strategji, plan social, agjend) qoftë në nivel kombëtar apo lokal, përcakton edhe formatin që do të përdoret për monitorimin dhe vlerësimin (M&V) e këtij dokumenti, me qëllim arritjen në kohë dhe cilësi të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara. Në këtë material, dokumenti bazë do të jenë Planet Lokale Sociale mbi të cilat do të ngrihet mekanizmi i M&V, ku do të përfshihen indikatorë cilësorë dhe sasiorë. Në kuadër të hartimit dhe zbatimit të Planeve Lokale Sociale, procesi monitorimit dhe vlerësimit do të ofroj informacion mbi orientimin e politikave dhe drejtimin strategjik në kuadër të fuqizimit dhe zgjerimit të shërbimeve sociale, si dhe mirë-përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare. Për të arritur objektivat strategjike, shumica e aktiviteteve të parashikuara në Planet Lokale Sociale, kërkojnë bashkëpunim dhe

bashkërendim të punës së aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë këtu njësitë e qeverisjes vendore, qendrore, donatorët, si dhe organizatat e shoqërinë civile.

Në mënyrë që të rritet llogaridhënia në çdo aktivitetet rekomandohet që të ketë të paktën një institucion përgjegjës për zbatimin e aktivitetit përkatës, sikundër dhe institucionet përgjegjëse për monitorimin. Në hartimin dhe zbatimin e Planeve Lokale Sociale, janë përfshirë shumë aktorë dhe institucione të ndryshme të cilët në shumicën e aktivitetëve të parashikuara në këto plane do të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për arritjen e objektivave dhe realizimin e aktivitetëve.

Prandaj, për një monitorim dhe vlerësim cilësor të tyre, është i domosdoshëm një bashkëpunim dhe mirëkoordinim midis aktorëve si në shkëmbimin e informacionit ashtu dhe në procesin e zbatimit të këtij plani. Në seksionet e mësipërme është theksuar se procesi i monitorimit dhe vlerësimit kalon përmes disa fazave si: Mbledhja e të dhënave; Analizimi i tyre; Raportimi dhe Llogaridhënia.

Një ndër hapat më të rëndësishëm në procesin e monitorimit është mbledhja e të dhënave dhe e informacionit të nevojshëm për matjen e indikatorëve përkatës. Ky informacion do të përdoret për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po zbatohen në praktikë sipas specifikimeve përkatëse, si dhe të mbledhë informacionin e nevojshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të planeve. Egzistojnë modele apo formate të ndryshme mbi raportimin e procesit të Monitorimit dhe Vlerësimit. Formatit më i thjeshtë apo i zakonshëm është matja e tyre përmes shkallës LIKERT, e cila përdor njësinë numerike nga 0-5 (Tabela 10).

**Table 10: Shkalla e vlerësimit të realizimit të indikatorëve.**

Realizimi	Shkalla e Vlerësimit	Legjenda Shpjeguese
I arritur plotësisht	5	= ose > 100% Indikatori raportuar është arritur plotësisht ose është tejkaluar
I arritur	4	> 80% dhe < ose = 99% Indikatori të raportuar
I arritur pjesërisht	3	> 60% dhe = ose < 80% Indikatori të raportuar
I arritur me vështirësi	2	>40% dhe = ose <60% Indikatori të raportuar
Mos realizim	1	>20% dhe =ose < 40% Indikatori të raportuar
I pa realizuar/pa matur	0	Aktiviteti nuk është ndërmarr ose indikatorët nuk janë arritur apo matur. = ose <20% e indikatorit të raportuar

Në tabelën 11, paraqitet një format i matricës së Monitorimit e cila është përshtatur për të mbledhur të dhënat nga aktivitetet e zbatimit të Planeve Lokale Sociale. Për qëllim demonstrimi, shifrat e paraqitura janë përdorur si numra tregues, ndërsa tabela e monitorimit përfshin një periudhë 4-vjeçare të zbatimit të aktivitetëve (2018-2022).

Tabela 11: Matrica e Monitorimit

No.	Përshkrimi Indikatorëve	Aktual (baseline) 2018	Qëllimi afat-mesëm (2020)	Realizimi (% dhe nr.) (Burimi informacionit)	Vlerësimi Indikatorëve	Qëllimi afatgjatë 2022
1. Shtylla Strategjike 1: Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve të kujdesit shoqëror						
Shkalla e Vlerësimit: 3						
1.1	Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në shërbimet e kujdesit shoqëror	4 persona	Në fund të vitit 2020 stafi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të rritet me 50%	50 % (rritje e nr. stafit me 2 persona)	5	Në fund të vitit 2022 stafi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor do të rritet me 30% - 50 %
1.2	Manuali i M&V në nivel bashkie për përdorim nga punonjësit që ofrojnë shërbimin dhe mbledhin të dhënat sektorin e kujdesit shoqëror	0	Deri në vitin 2020 do ketë përfunduar manuali dhe plani i monitorimit	0 Manuali në proces rishikimi për përfshirjen e komenteve nga partnerët (kopje draft e materialit)	2	Deri në fund të vitit 2022 sistemi M&V do të jetë I shtrirë dhe funksional në nivel vendor
1.3	Fuqizimi dhe zgjerimi i strukturave të monitorimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	2 persona	Në fund të vitit 2020 numri stafit të trajnuar do të rritet me 100%	50% (rritje e numrit të stafit me 1 person)	2	Deri në fund të 2022 strukturat e monitorimit në nivel vendor do të jenë rritur me 50%
2. Shtylla Strategjike 2: Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara (PAK) mbi 18 vjeç, nëpërmjet ofrimit të “Shërbimeve në familje”.						
<i>(Persona të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal).</i>						

#### Shkalla e Vlerësimit: 4

2.1	<i>Hartimi i Procedurave Standarte të Operimit (PSO) mbi shërbimin social-shëndetësor në banesë.</i>	0	Në fund të vitit 2020 do të ketë përfunduar dhe miratuar PSO për PAK	100% POS përfunduar, miratuar për zbatim në nivel vendor	5	Deri në fund të vitit 2022 POS do të zbatohet në gjitha njësitë vendore në nivel Qarku
2.2	<i>Përzgjedhja e ekipit social-shëndetësor që do të ofrojnë me kohë të pjesshme shërbime në banesë.</i>	12 persona	Në fund të vitit 2020 stafi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të rritet me 50%	33% (rritje e nr. stafit me 2 persona)	2	Në fund të vitit 2022 numri i stafit që do të ofrojnë me kohë të pjesshme shërbime në banesë do të rritet me 30%
2.3	<i>Identifikimi i personave që kanë nevojë për shërbim në familje</i>	100 persona	Në fund të vitit 2020 numri i personave me PAK që marrin shërbime në familje do të rritet me 20%	95.8% (115 persona të shërbyer)	5	Deri në fund të vitit 2022 që kanë nevojë për shërbim në familje do të rritet me 50%

### 3. Shtylla Strategjike 3: Mbështetja dhe Fuqizimi i familjeve në nevojë

#### Shkalla e Vlerësimit: 3.3

3.1	<i>Identifikimi i familjeve aplikante, të cilat nuk përfitojnë nga skema e NE</i>	150 familje	Në fund të vitit 2020 numri i familjeve përfituese do të rritet me 20%	33.3% (160 familje)	2	Deri në fund të vitit 2022 numri i familjeve përfituese që nuk përfitojnë nga skema e NE do të rritet me 30%
-----	---	-------------	--	---------------------	---	--

3.2	Mbështetje për fuqizimin ekonomik të grave	0	Në fund të vitit 2020, numri I grave kryefamiljare nga familjet në nevojë të mbështetura me programe të zhvillimit ekonomik do të jetë 20 persona	100% (20 gra)	5	Deri në fund të vitit 2022, numri I grave kryefamiljare nga familjet në nevojë të mbështetura me programe të zhvillimit ekonomik do të do të rritet me 50%
3.3	Mbështetje për punësimin e të rinjve dhe sipërmarrjen	0	Në fund të vitit 2020, numri te rinjve të mbështetur do të jetë 40 persona	70% 28 persona të mbështetur	3	Në fund të vitit 2022, numri te rinjve të mbështetur do të rritet me 50%

Shtylla Strategjike 4: *Adresim efektiv i nevojave për rehabilitim dhe fuqizim të viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit*

### Shkalla e Vlerësimit: 3.5

4.1	<i>Ngritja e infrastrukturës së shërbimit të emergjencës 72 orëshe për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit</i>	0	Në fund të vitit 2020 ambjentet për shërbimin e emergjencës janë të gatëshme në përputhje me standartet e këtij shërbimi	100 % (godina dhe ambjentet e brendëshme të gatëshme për ofrimin e shërbimit)	5	Në fund të vitit 2022 shërbimi do të jetë tërësisht funksional për viktimat e dhunë në familje dhe të trafikimit
4.2	<i>Përzgjedhja e ekipit që do të ofrojë shërbim.</i>	0	Deri në vitin 2020 do ketë përfunduar rekrutimi i personelit.	50% Për arsye financiare është rekrutuar vetëm 50% e	2	Deri në fund të vitit 2022 shërbimi do të jetë tërësisht funksional për viktimat e dhunës në

				personelit të parashikuar		familje dhe të trafikimit
<b>Shtylla Strategjike 5: Zhvillimi i sistemit të integruar të shërbimeve shëndetësore dhe sociale me bazë komunitare për të moshuarit</b>						
<b>Shkalla e Vlerësimit: 4</b>						
5.1	Hartimi i Procedurave Standarte të Referimit të Rastit mes strukturave shëndetësore dhe sociale.	0	Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 do të jenë përgatitur e miratuar PSR për të moshuarit në nevojë për shërbim në banesë	100% PSR përfunduar, miratuar për zbatim në nivel vendor	5	Deri në fund të vitit 2022 PSR do të zbatohen nga strukturat e shëndetësisë dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
5.2	Përzgjedhja e ekipit psiko-social që do të ofrojnë shërbime në banesë për të moshuarit.	0	Në fund të gjashtë mujorit të parë të vitit 2020 stafi do të jetë përzgjedhur.	100% (personeli i parashikuar është rekrutuar)	5	Në fund të vitit 2022 ofrohet shërbimi nga ekipi i profesionistëve në përputhje me standartet kombëtare
5.3	Referimi tek shërbimi i të moshuarve që kanë nevojë për shërbim në familje	0	Në fund të vitit 2020 80 të moshuar përfitojnë nga shërbimi në familje	50% (40 të moshuar të përfshirë në shërbim)	2	Deri në fund të vitit 2022 çdo i moshuar në situatë të vështirë social-ekonomike që ka të nevojshëm shërbimin në banesë ka akses tek kjo formë shërbimi.
<b>Shtylla Strategjike 6: Mbrojtja dhe përkujdesi ndaj fëmijëve të rrezikuar nga trafikimi</b>						

Shkalla e Vlerësimit: 4

6.1	Ngritja e Skudrave të Lëvizshme për identifikimin proaktiv të rasteve të fëmijëve në situatë rruge	0	Në tremujorin e parë të vitit 2020 janë ngritur 50% të skudrave të lëvizshme të parashikuara	100% (dy ekipe të ngritura)	5	Deri në fund të vitit 2022 janë aktive 5 skudra të lëvizshme.
6.2	Trainim i ekipeve përbërëse të skudrave të lëvizshme mbi çështjet e trafikimit të fëmijëve, menaxhimin dhe referimin e rasteve tek shërbimet specifike	0	Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020, ekipi ka përmbyllur të gjithë ciklin e trainimeve	100%  (të gjitha trainimet e parashikuara janë kryer me pjesëmarrjen e plotë të ekipit)	5	Deri në fund të vitit 2022, ekipet e skudrave të lëvizshme janë trainuar dhe kanë kapacitetet e nevojshme për të përbushur detyrat funksionale.
6.3	Identifikim proaktiv i rasteve të fëmijëve të rrezikuar nga trafikimit	15	Në fund të vitit 2020, numri i fëmijëve të nxjerrë nga situata e rrugës do të jetë 60	50%  30 femije të mbështetur	2	Në fund të vitit 2022, asnjë fëmijë në situatë rruge.

## Modele Formati të statusit të realizimit të Treguesve dhe Raportimit të Masave të Veprimit (Numra dhe Përqindje).

Të dhënat në Tabelën 11, tregojn se në planin e monitorimit janë përfshirë 9 (nëntë) masa veprimi, të cilat janë shprehur në numër masash dhe përqindje. Tabela 12, paraqet në mënyrë të përmbledhur ecurin e masave të raportuara.

Table 12: Statusi i realizimit të Treguesve (në Numër dhe Përqindje)

Statusi përparimit	Shprehur në numër	Shprehur në %
I arritur plotësisht	4	44.4%
I arritur	0	-
I arritur pjesërisht	1	11.2%
Mosrealizim	4	44.4%
I pa realizuar/pa matur	0	-
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>100%</b>

*Për më shumë informacione në lidhje me formatet e raportimit dhe të monitorimit, referojuni Aneks A në fund të këtij dokumenti.*



## Ankes A: Matrica e Monitorim&Vlerësimit dhe Formatit i Raportimit

Table 13: Korniza logjike e indikatorit të projektit

Indikatori	Aktual (Baseline)	Synuar (Target)	Afati kohor	Kuari Ligjor	Personi përgjegjës	Burimet Financiare				Mënyrat e verifikimit	Monitorimi	Realizimi
						Qeveria	Bashkia	Donator	Hendeku financiar			
<b>Rezultati (Outcome) 1:</b>												
<b>Objektivi 1:</b>												
<b>Objektivi 2:</b>												
<b>Objektivi 3:</b>												

Table 14: Tabela e Monitorimit të Indikatorëve

Fusha e Veprimit	Përshkrimi i treguesve	Synimi aktual	Synimi afat-mesëm	Synimi afat-gjatë
Mirëqeverisja në funksion të promovimit dhe zgjerimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale për fëmijët në situatë rruge.	Numri i planeve sociale lokale të hartuara për fëmijët në situatë rruge.	Planet Lokale Sociale për Fëmijët në Situatë Rruge <b>po zbatohen në 6 Bashki</b> dhe ka patur rezultate pozitive në shumicën prej tyre.  Në raportin e vitit 2019 - 2020 janë <b>menaxhuar në total 500 raste të fëmijëve</b> në situatë rruge.	Deri në fund të 2022, Planet Lokale Sociale për Fëmijët në Situatë Rruge po zbatohen <b>edhe në 6 Bashki tjera dhe do të menaxhohen në total 1.500 fëmijë.</b>	Deri në fund të 2025, Planet Lokale Sociale për Fëmijët në Situatë Rruge <b>do të zbatohen në 50% të bashkive në nivel vendi dhe do të menaxhohen 3.000 fëmijë.</b>
Sisteme dhe shërbime shëndetësore miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.	Standardet e zhvillimit, përkujdesjes dhe mirërritjes në kujdesin e hershëm në sistemin parashkollor të hartuara dhe të miratuara.	<b>Nuk ka ende standarde</b> e as programe të miratuara për zhvillimin në fëmijërinë e hershme.	Deri në fund vitit 2018 pilotohen programet e zhvillimit për fëmijërinë e hershme në <b>3 Bashki.</b>	Deri në fund vitit 2020 zbatimi i standardeve dhe programeve për fëmijërinë e hershme <b>shtrihet në 100% të Bashkive.</b>
	% e rritjes së strukturave të inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	Kapacitetet aktuale të institucioneve përgjegjëse, duke përfshirë ato në nivel vendor, nuk janë efektive për të inspektuar shërbimet e përkujdesit shoqëror, me fokus tek fëmijët.	Në fund të vitit 2021 stafi shërbimeve sociale në bashki do të <b>rritet me 50%.</b>	Në fund të vitit 2025 stafi i shërbimeve sociale në bashki në nivel vendi, do të <b>rritet me 30% - 50 % punonjës të tjerë.</b>

## Formati (Matrica) e Vlerësimit

Formati vlerësimit shërben për të grumbulluar në “një flet të vetme” të gjithë informacionin që do të përdoret gjatë procesit të vlerësimit. Të gjithë komponentët e formatit të vlerësimit janë të lidhur me njëri tjetrin dhe na ndihmojnë të zhvillojmë një plan të mirëfillt pune për mbarë vajtjen e vlerësimit (Tabela 10).

Table 15: Formati Vlerësimit

Kriteret Vlerësuese	Pyetjet Vlerësuese		Qëllimi dhe Objektivat	Informacioni	Burimi	Metoda
	Pyetjet Kryesore	Pyetjet Mbështetëse				
Relevanca						
Eficientia						
Efektiviteti						
Qëndrueshmëria						
Tjetër						

## Formati Raportit Final të Monitorimit/Vlerësimit të programit

Në fund të monitorimit apo vlerësimit, duhet pregatitur raporti final, i cili përmban gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Në përgjithësi, rekomandohet që raport të përmbajë seksionet e mëposhtme<sup>6</sup>:

<b>Tituli i Raportit</b>	përfshin emrin e institucionit, projektit, periudhën e shkrimit të raportit si dhe autorët/personat përgjegjës.
<b>Lista e shkurtimeve</b>	të gjitha shkurtesat e përdorura në raport, duhet të përfshihen në këtë seksion, sipas rendit alfabetik.
<b>Falenderimet</b>	personat që kanë dhënë kontribut në procesin hartimit të raportit, si: agjensitë zbatuese apo mbështetëse, përfituesit e programit, stafin e projektit apo partnerët. Rekomandohet që ky seksion të jetë më pak se 1 faqe.
<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	përshkruhet në mënyrë të përmbledhur të gjitha detajet e rëndësishme të projektit. Është seksion i rëndësishëm, pasi është pjesa hyrëse ajo që tërheq apo jo interesin e lexuesit mbi përmbajtjen e raportit. Rekomandohet një paragraph për cdo seksion të raportit dhe jo më shumë se dy faqe.
<b>Tabela e përmbajtjes</b>	përmban list të gjitha seksioneve të përfshira në raport, shoqëruar dhe me numrin përkatës të faqes.
<b>Hyrje</b>	informacion mbi projektin dhe analizim të situatës për temën që trajton projekti (psh.: shërbimet sociale në Shqipëri). Në fund të këtij seksioni, përmes një paragrafi jepet në mënyrë të përmbledhur arsyeja pse po realizohet raporti dhe për Çfarë do të shërbejnë gjetjet e tij.
<b>Metodologjia</b>	përshkruan metodologjinë sesi vlerësimi është realizuar: metodologjia e kërkimit, burimi informacionit, mbledhja e të dhënave, përzgjedhja e kampionit, instrumentat e mbledhjes së të dhënave, besueshmëria e metodologjisë, çështje etike, etj.
<b>Rezultatet</b>	përshkruhen në mënyrë të detajuar gjetjet nga vlerësimi i projektit. Gjetjet e analizuara krahasohen me objektivat apo indikatorët përkatës të projektit.
<b>Konkluzionet</b>	kjo është një ndër pjesët më të rëndësishme të raportit, pasi përmes gjetjeve nxirren konkluzionet (arritjet/sfidat) nga zbatimi i projektit.
<b>Rekomandimet</b>	përmbledhen në mënyrë të detajuar mësimet e nxjerra nga zbatimi i projektit, jepen rekomandimet për përmirësimin e performancës dhe vazhdimësinë e tij.
<b>Anekset</b>	përfshihen të gjithë dokumentacioni/aneokset e nevojshme si psh: matrica mbledhjes së të dhënave, analiza specifike, instrumentat e vlerësimit, etj.

<sup>6</sup> <https://impact-evaluation.net/2013/06/04/final-report-format/>